

## Llojet e Çështjeve:



ÇESHTJE FAMILJARE



MOSMARRËVESHJE NË PUNË



REGJISTRIM CIVIL



SIGURIME SHOQËRORE



PENSION



PËRKRAHJE SOCIALE



TË DREJTAT E NJERIUT

Ku do të kontaktojmë Avokatin e Ndihmës Juridike ?

Qendra shtetërore e ndihmës juridike  
Bashkia Kavajë

dhe

Shërbimi Ligjor Flas Tiranë, TLAS



# KENI NEVOJË PËR NDIHMË JURIDIKE?

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

dhe

Qendra Shtetërore e Ndihmës  
Juridike Falas Kavajë

me mbështetjen e

**UNDP**

ofrojnë

**NDIHMË JURIDIKE  
FALAS PËR INDIVIDËT NË NEVOJË**

Kontakti:

Cel: 068 38 01 607

Cel: 069 20 93 731

[Ndihmajuridikekavaje@drejtesia.gov.al](mailto:Ndihmajuridikekavaje@drejtesia.gov.al)

[tlas@tlas.org.al](mailto:tlas@tlas.org.al)

[www.portal.tlas.org.al](http://www.portal.tlas.org.al)

**E HËNË - E PREMTE**

**9:00 - 14:00**



## Cfarë kuptojmë me Ndhimë Juridike

Me Ndhimë Juridike kuptojmë ofrimin e shërbimeve ligjore falas për individët në pamundësi financiare për të zgjidhur dhe realizuar të drejtat e tyre.

Ligji nr. 111/2017 "Për Ndhimën Juridike të garantuar nga Shteti" përcakton kushtet, llojin, mënyrën dhe procedurat për dhënie të ndihmës juridike nga ofruesit e qendrave shtetërore dhe jo shtetërore, për t'ju siguruar qytetarëve në nevojë mbrojtjen e të drejtave themelore dhe interesave të tjera të ligjshme.

## Kush janë Parimet themelore të Ndhimës Juridike

### Ndhimja juridike bazohet në:

- Parimin e barazisë së të drejtave për individët që duhet të përfitojnë ndihmë juridike;
- Parimin e profesionalizmit të ofruesve të ndihmës juridike;
- Parimin e cilësisë së shërbimit të ndihmës juridike;
- Parimin e ruajtjes së konfidencialitetit;

## Cilat janë format e Ndhimës Juridike?

### 1. Ndhimja Juridike Parësore që përfshin:

- Informacionin për sistemin ligjor, të drejtat e detyrimet e subjekteve të ligjit dhe aktet normative në fuqi;
- Mënyrat e ushtrimit të të drejtave të individit për hartimin e kërkesave, dokumenteve apo formave të tjera juridike për përdorim në proceset gjyqësore dhe jashtëgjyqësore;

### 2. Ndhimja Juridike Dytësore që përfshin:

- Përfaqësimin në proceset gjyqësore penale, civile dhe administrative;
- Shërbimin klinik dhe përmes internetit për klientët që mbasi këshillohen dhe përgatiten me dokumentat përkatëse ligjore, mund të vet-përfaqësohen në gjykatë ose administratën publike
- Cdo qytetar mund të marrë ndihmë juridike, për të gjitha çështjet, nëpërmjet:

[Portal.tlas.org.al](http://Portal.tlas.org.al)  
[Platforma Juristionline.al](http://Platforma.Juristionline.al)

## 3. Ndhimja juridike nëpërmjet edukimit ligjor të publikut:

- Përmes publikimeve;
- Fushatave në median vizive, të shkruar dhe atë sociale;
- Aktivitete ndërgjegjësuese dhe informuese në komunitet, organizuar nga studentët të fakulteteve dhe klinikave ligjore;

## Cilët persona përfitojnë Ndhimë Juridike?

Përfitojnë ndihmë juridike falas persona në nevojë për ndihmë juridike në çështjet civile dhe administrative dhe që nuk kanë mundësi financiare për të paguar si:

- Të miturit dhe jetimë;
- Gratë e dhunuara dhe pa të ardhura;
- Personat me aftësi të kufizuar;
- Personat në rrezik dhe pa shtetësi;
- Pensionistë dhe të moshuar, etj.